



01-247



	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	<p>PRISHTINA</p> 
---	--	--

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05-391/02-37893/23 dt.21.02.2023, të kërkuësve/bashkëpronarëve, Minire Xhambazi, Nexhip Xhambazi, Ferzije Xhambazi, Ylvije Xhambazi, dhe Kimete Simnica nga Prishtina dhe investitorit “Dardania SH Company” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Bajram Kelmendi”, nr. 54/03, me certifikate të biznesit ARBK 71252876, dhe investitorit “Ada Consulting Group” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Nora e Hotit”, Bll. C2-10 Obj. B H1-4/2, me certifikate të biznesit ARBK 810794215, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesat: “A1”, “A2”, “A3”, “A4”, dhe “A5”, e ndërtuar në kuadër të bllokut urban “E1”, “E4”, të Ndryshim dhe Plotësimi i Planit Rregullues “ Arbëria 3” në Prishtinë, në rr. “Sofokliu” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës në procedurë administrative, me datë 16.08.2024, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET kërkuësve / bashkëpronarëve Minire Xhambazi, Nexhip Xhambazi, Ferzije Xhambazi, Ylvije Xhambazi, dhe Kimete Simnica nga Prishtina dhe investitorit “Dardania SH Company” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Bajram Kelmendi”, nr. 54/03, me certifikate të biznesit ARBK 71252876, dhe investitorit “Ada Consulting Group” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Nora e Hotit”, Bll. C2-10 Obj. B H1-4/2, me certifikate të biznesit ARBK 810794215, sipas kërkesës 05-391/02-37893/23 dt.21.02.2023, përdorimi i ndërtesave shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesat “A1”, “A2”, “A3”, “A4”, dhe “A5”, me etazhitet B+S+P+4, dhe e ndërtuar sipas “Vendimit për Lejimin e Ndërtimit”, 05 Nr.351/02-0103167/18 dt.25.07.2018, në parcelat kadastrale nr. 2966-1 dhe 2966-2, ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër të bllokut urban “E1”, “E4”, të Ndryshim dhe Plotësimi i Planit Rregullues “ Arbëria 3”, në Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Sofokliu” ku ka dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: Nr. 2, 4, 6, 8, 10, 12, 14, 16, 18, 20, 24, 26, 28, 30, 32, 34, 36, 38, 40, 42, 44, 46, 48, 50, 52, 54, 56, 58, 60, 62, 64, 66, 68, 70, 72, 74, 76 dhe 78, në Prishtinë, dhe e njejtat do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

Kërkuesit / bashkëpronarët, Minire Xhambazi, Nexhip Xhambazi, Ferzije Xhambazi, Ylvije Xhambazi, dhe Kimete Simnica nga Prishtina dhe investitorit “Dardania SH Company” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Bajram Kelmendi”, nr. 54/03, me certifikate të biznesit ARBK 71252876, dhe investitorit “Ada Consulting Group” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Nora e Hotit”, Bll. C2-10 Obj. B H1-4/2, me certifikate të biznesit ARBK 810794215, me kërkesën 05-391/02-37893/23 dt.21.02.2023, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesat “A1”, “A2” A3”, “A4”, dhe “A5”, me etazhitet B+S+P+4, te ndërtuar në kuadër të bllokut urban “E1”, “E4”, te të Ndryshim dhe Plotësimi i Planit Rregullues “ Arbëria 3” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të në parcelat kadastrale nr. 2966-1 dhe 2966-2, ZK Prishtinë, ndërtuar sipas “Vendimit për Lejimin e Ndërtimit”, 05 Nr.351/02-0103167/18 dt.25.07.2018, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-6223/23 dt. 08.02.2023, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografji gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Krenar Veseli; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Skender Loshi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Gresë Qorri; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Agim Kastrati; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Arton Hetemi; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, kompania gjeodete e licensuar “GeoHorizont” me nr. të licensës 54;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm si dhe aneksi mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që kompleksi me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për kompleksin me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm.



Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, përmes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-37893/23 DT. 16.08.2024

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu
B. Vllasaliu

Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



